



Panairi "Blej Shqip" - iniciativa që do të kthehet në traditë

Fjala e Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti dhe Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Arben Ahmetaj në inaugurimin e Panairit të përbashkët "Blej Shqip", Prishtinë, 2014

Të nderuar deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të nderuar deputet të Kuvendit Komunal të Prishtinës, i nderuar ministri në detyrë Fadil Ismajli dhe i nderuari ambasador Minxhozi, unë sot së bashku me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Sipërmarrjes dhe Tregtisë së Republikës së Shqipërisë kemi kënaqësinë që të prezantojmë para jush një projekt të përbashkët, një iniciativë të përbashkët që e kemi filluar tash e ca muaj që në këtë ditë të madhe të festës së kombit, të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë të konkretizojmë me një iniciativë e cila e ka domethënien në shumë nivele.

Ju e dini se që nga dita e djeshme ka filluar ekspozimi i produkteve shqiptare, se më nuk po them veç vendore sepse e gjithë motoja e kësaj iniciative është "Blej Shqip", koncepti është që të blejmë produkte dhe prodhime shqiptare si një rrugë drejt fuqizimit ekonomik të kombit tonë. Pak më parë patëm një takim me Ministrin Ahmetaj ku i diskutuam disa çështje ekonomike të cilat ndërlidhen me bashkëpunimin ekonomik. E biseduam edhe me Ambasadorin Minxhozi që shkëmbimet tregtare të cilat i ka Republika e Kosovës me Republikën e Shqipërisë me të vërtetë janë minimale në krahasim me atë se cili është potenciali i shqiptarëve që të prodhojnë, të bëjnë shkëmbime ndërmjet veti dhe t'i zëvendësojmë një shumë të madhe parash të importeve të cilat i ka edhe Kosova dhe Shqipëria. E gjithë kjo me qëllimin e fuqizimit ekonomik të kombit shqiptar dhe krijimin e vendeve të reja të punës që do të sillnin një zhvillim të mirëfilltë ekonomik.

Dëgjuam se muajve të fundit janë paraqitur disa probleme të vogla, siç janë tarifat kufitare, probleme të cilat i kanë prodhuesit, e sot e dëgjova edhe zotimin e Ministrit Ahmetaj dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që me të vërtetë këto pengesa do të mënjanohen plotësisht dhe do të kemi një integrim të plotësuar të tregut, i cili do të na mundësonte të shesim dhe të blejmë pa tarifa fare, brenda hapësirave të kombit shqiptar. Shpresojmë që të ndodhë sa më shpejtë. Ne si Komunë do ta bëjmë presionin patjetër, por shpresojmë se edhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë që me institucionet e reja të fillojnë sa më shpejtë me këto procedura në mënyrë që mos të ketë pengesa të tilla.

Ndërsa, sot jam i lumtur për shkak se m'u drejtuan të gjithë ata tregtarë, prodhues që i kanë ekspozuar prodhimet në panairin "Blej Shqip" që janë shumë të kënaqur sepse dje ka pasur shumë vizitorë dhe ka pasur tepër shumë njerëz që kanë blerë produkte shqiptare. Dhe kanë kërkuar ky panair të zgjatet edhe gjatë ditës së nesërme, edhe për një ditë që do të thotë potenciali ekziston, interesimi ekziston dhe kjo ka të bëjë thjesht me një koncept ekonomik.

E kam thënë shumë herë se promovimi i prodhimeve vendore nuk është çështje emocionale, nuk duhet të blejmë prodhime vendore vetëm pse po ndjehemi mirë se janë shqiptare. Ky është koncept ekonomik. Këtë e bëjnë edhe SHBA-të, edhe shtetet evropiane sepse është lidhja direkte midis konsumit të prodhimeve vendore, zhvillimit të prodhimit dhe krijimit të vendeve të punës. Njëjtë sikur ia kam bërë edhe ofertën supermarketeve në Prishtinë që t'i ekspozojnë prodhimet vendore të parat sepse po u shitën më shumë prodhime vendore, ne do të krijojmë më shumë fuqi blerëse, njerëzit do të kenë më shumë para të blejnë edhe në supermarketet e tyre, pra ky është një zinxhir tepër i thjeshtë.

Unë e përgëzoj Ministrin Ahmetaj që sot është në Prishtinë që edhe një herë të rikonfirmojmë zotimin për bashkëpunim, për largimin e të gjitha tarifave, për një koncept të zhvillimit ekonomik të përbashkët dhe në këtë drejtim besoj se nuk do të ndalemi këtu. Unë e kam thënë që ne si Komunë e Prishtinës do të bëjmë gjithçka që



është e mundur për ta mundësuar këtë. Thash se e kemi ftuar këtu edhe Ministrin dhe besojë që edhe në të ardhmen, pa marrë parasysh se cilave subjekte politike iu takojmë, sepse po shoh nga të gjitha subjektet politike prezente që të gjithë ta bëjmë detyrën tonë për një qëllim të përbashkët, për zhvillimin e kombit tonë.

Ministër Ahmetaj mirë se keni ardhur dhe ju ftojë që edhe zyrtarisht ta hapim panairin “Blej Shqip”.

Ministri Arben Ahmetaj

Të dashur miq, i dashur Kryetar, i dashur miku im Shpend, të dashur pjesëmarrës

Së pari iu urojë festën e përbashkët të flamurit, edhe për mijëra e mijëra vjet.

Për mua është kënaqësi e veçantë që festën e kaloj në Prishtinë, është kënaqësi personale edhe për shkak të lidhjeve miqësore që kam me shumë prej jush, por ndërkohë kemi së bashku një event tejet të rëndësishëm dhe interesant të realizuar me Komunën e Prishtinës, “Blej Shqip”.

Jam dakord me Shpendin, është koncept ekonomik, nuk është emocionale. Ne sot në Shqipëri po flasim për një model të ri ekonomik dhe thelbi i modelit të ri është prodhimtaria vendase. Do të japë një statistikë të cilën e përmend shpesh për të treguar hapësirën e mundësive të zhvillimit ekonomik, qoftë në Shqipëri, qoftë në Kosovë, qoftë në të gjitha trevat shqiptare. Sot ne në Shqipëri importojmë 800 milionë euro ushqime dhe në produkte ushqimore. Fakt i papranueshëm është se që të gjitha janë produkte ushqimore të cilat dikur i kemi prodhuar vetë, madje edhe i kemi eksportuar.

Thelbi i zhvillimit tonë ekonomik është zhvillimi bujqësor, zhvillimi i agro-industrisë në mënyrë që dalëngadalë në vite të kemi mundësinë që këtë 800 milionësh ta xerojmë. E njëjta gjë është edhe për artikujt industrialë dhe jemi të bindur se po qe se fokusohemi po në këtë koncept të zhvillimit ekonomik, po pse jo edhe në konceptin emocional, patjetër, nuk e kam këtë kompleks për ta mohuar, në 10 ose 15 vite të kemi një raport komplet tjetër dhe të drejtë në favor të punësimit në trojet shqiptare, në favor të rritjes së eksporteve dhe të pasurimit të të gjithë sipërmarrjeve dhe qytetarëve shqiptarë në të gjitha trevat.

Me kënaqësi e them se sot janë mbi 100 sipërmarrje nga Shqipëria, Kosova, nga sipërmarrjet shqiptare në Maqedoni dhe jam i bindur se vitin tjetër do të kemi edhe nga sipërmarrjet shqiptare në Preshevë, në daç këtu, në daç në Tiranë kudo që të vendosim ta bëjmë së bashku. Është një sipërmarrje ndërgjegjësuese si event sot, për t'i treguar të gjithë shqiptarëve që ne dimë të prodhojmë mirë, ne dimë të prodhojmë për veten tonë, ne dimë të prodhojmë edhe për eksportin. Shumë prej jush e dinë shumë mirë që shumë produkte shqiptare janë produkte të konsumuara me kënaqësi në shumë tregje evropiane. Në të njëjtën kohë, unë mendoj si Ministër i Zhvillimit Ekonomik që ne akoma nuk kemi bërë mjaft për t'i integruar të dyja tregjet tona.

Pra, tregu shqiptar dhe tregu kosovar nuk janë dy tregje të ndara, pavarësisht se po të shohësh raportet e import-eksportit, pra të shkëmbimeve tregtare, akoma nuk janë ato që ne duam të jenë. Dhe ndajmë më Shpendin edhe vendosmërinë qoftë personale, qoftë institucionale dhe me institucionet e reja të Kosovës, me formimin e Qeverisë së shpejti, të bashkëpunojmë në mënyrë që ato tarifa doganore, ato pengesa jo tarifore, nuk do të duhet të ekzistonin dhe jo thjeshtë retorikë politike, por një eksperiencë dhe një bashkëpunim ekonomik.



Unë së bashku me Ministrinë e Ekonomisë së Kosovës dhe Komunën e Prishtinës, në janar do të ndërmarrim një iniciativë të detajuar për çdo pengesë dhe çdo mundësi që të dy tregjet tona kanë për t'i adresuar dhe për t'i promovuar. Pra, për t'i adresuar problemet që kemi në tregti, në shkëmbimet tregtare dhe për të promovuar ato mundësi të përbashkëta për ta çuar nivelin e zhvillimeve tregtare, pse jo mbi 500 milionë, për të tërhequr sa më shumë produkte shqiptare. Por, në të njëjtën kohë do të duhet të punojmë më shumë me Qeverinë e Kosovës dhe me ju për të përdorur portin e Durrësit.

Ai është një port shqiptar, është dhe porti i juaj. Ne kemi një marrëveshje ndërqeveritare për lehtësimin e procedurave doganore për sipërmarrjen kosovare. Do të duhet të jemi pak më të vendosur për të përdorur më zgjuar atë aset kombëtar në favor të zhvillimit ekonomik të të gjithë tregut shqiptar.

Edhe një herë, për mua është kënaqësi e veçantë. Është nder që jam pjesëmarrës dhe i ftuar nga Shpendi, Kryetari i Komunës. Takojë miq të mirë, si Ministri, Albini dhe shumë deputetë të parlamentit të Kosovës dhe njëherë uroj të konsumojmë sa më shumë mallra shqiptare dhe gëzuar festën e flamurit, festën mbarëkombëtare.

Faleminderit të gjithëve!

Përgjigjet në pyetjet e gazetarëve

Ministri Ahmetaj: Për sa i përket tarifave doganore ne pjesën më të madhe e kemi hequr. Ka një pjesë të vogël të tarifave dhe të pengesave jo tarifore që akoma janë prezente. Dua të ndaj me ju edhe një informacion. Ministria e Ekonomisë me Universitetin Ekonomik të Shqipërisë ka ndërmarrë një studim së bashku me Kenedy School of Government, pra me Universitetin e Harvardit, për të parë në detaje se çfarë problemesh ka fluksi tregtar, ndërsjella tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës, në mënyrë që t'i marrim një nga një pastaj dhe për t'i adresuar dhe zgjidhur.

Po e marrë një shembull i cili është pengesë siç është certifikimi i produkteve. Të dy sipërmarrjet, qoftë nga Kosova, qoftë nga Shqipëria kanë ecejaket e tyre për të certifikuar produktet, qoftë kosovare, qoftë shqiptare, pra nga të dyja anët. Një nga elementet e para që do të arrijmë të bëjmë është unifikimi i certifikimit. Në qoftë se ka një certifikim kosovar, atëherë është i njohur në tregun shqiptar si certifikim legal dhe anasjelltas. Gjë që do të na bëjë ta lehtësojmë jashtëzakonisht shumë tregtinë.

E dyta, do të duhet të kemi një instrument të zgjidhjes së konflikteve, që nganjëherë janë konflikte, do ta përdorë këtë fjalë, konflikte idiote. Pse? Për shkak të moskomunikimit. Do të duhet të kemi një instrument shumë të shpejtë. Nuk kemi nevojë të kemi një instrument alla OBT që të presim me 4, 5, 6 muaj për të zgjidhur një problem. Por mund të jetë për 1-2 ditë, mund të jetë një instrument i përhershëm, por shumë i thjeshtë për zgjidhjet e konflikteve.

E treta është, besoj unë, nuk kemi mjaft njohuri për produktet e njëri-tjetrit. Pra, nuk kemi njohuri për kapacitetet e sipërmarrjeve për të furnizuar tregun shqiptar.

E katërta, do ta theksojë, është, dhe këtë do ta bëjmë, do një fushatë informimi qoftë nacional, qoftë komercial të konsumimit shqip. Pra, nuk kemi pse të kemi kompleks për të promovuar produktet shqiptare në të gjitha mënyrat, në shkolla, në kopshte, në ushtri kudo që të jetë e mundur, në mënyrë që të fusim një kulturë dashurie ndaj produkteve shqiptare.



Shpend Ahmeti: Diskutuam me Ministrin Ahmeti që për studimin e përbashkët të Qeverisë së Shqipërisë dhe Universitetit të Harvardit, të marrim pjesë edhe ne nga Republikës e Kosovës në mënyrë që të gjitha ato sfida të cilat janë identifikuar, t'i shohim dhe t'i zgjidhim edhe bashkërisht.

Me Ambasadorin Minxhozi kemi diskutuar shumë herë që të punojmë drejtë standardeve të njëjta, që do të ishte një hap drejt integritit të tregut tonë. Pra, që të mos diskutojmë se a është një sasi e proteinave në miell e ndryshme prej Shqipërisë në Kosovë, por të punojmë në standarde të përbashkëta, të cilat pastaj as nuk do të kishin nevojë për verifikim në kufi që ta zbusim edhe këtë barrierë.

Besoj që tash e tutje nuk ka pengesa politikë të cilat janë brenda kombit shqiptar, të cilat do të ishin pengesa të papërballeshme që ne ta arrijmë këtë integritet të tregut tonë.

Bashkëpunimi i Prishtinës me Tiranën është tepër i rëndësishëm. Unë e kam potencuar disa herë, kam qenë në vizitë në Tiranë, jam takuar edhe me kryetarin e Tiranës, po ashtu edhe me institucionet qeveritare dhe në këtë drejtim kam propozuar që të kemi një bashkëpunim konkret, i cili do të jetë bashkëpunim i dy kryeqyteteve në zbatimin e projekteve të përbashkëta.

Prishtinë, 28 nëntor 2014